

# HISTORIA E SIMBOLIT TONË KOMBËTAR DHE DODONA PELLAZGJIKE

Mrsc. Besim **DERVISHI**<sup>1</sup>

## PËRMBLEDHJE

Shumë shkrime, editoriale, punime shkencore, libra dhe emisione televizive janë bërë në lidhje me mitin e simbolit tonë kombëtar shqiponjës së zezë dykrenare. Analizat dhe debatet arriten kulmin sidomos në njëqind vjetorin e pavarsisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 2012. Nga të gjitha mendimet e dhëna apo idetë u vu re se u anashkaluan disa prova dhe fakte të cilat, mitin e simbolit tonë kombëtar e lidhin me Dodonën Pellazgjike në malin e Tomorrit, në Shqipëri. Në këtë shkrim nuk do ti hyjmë arsytimit nëse Orakulli i shenjtë i Dodonës Pellazgjike ka qënë në malin e Tomorrit. Kjo është e qartë mjafton të lexohen shkrimet e lashta me kujdes, si dhe të analizohen ato me një mendje krejt të kthjellët. Mjafton të studiohen librat dhe punimet të cilat kanë lënë autorë të lashtësisë si Herodoti, Plinius, Strabon, Hesiodi, Plutarku dhe të tjerë. Mjafton të studiohen veprat e rilindasve tanë si Kristoforidhi, Jani Vreto, Sami dhe Naim Frashëri, Çajupi, Ismail Qemali, Eqerem Vlora, Perikli Ikonimi, Ali Asllani, Hil Mosi. Shumë autorë dhe midis tyre dhe P. Ikonimi në librin e tij me titull "Historia e Tomorrit", thotë se Zeusi sipas mitologjisë ishte zot i Iliro-Pellazgeve, ai ishte i biri i Saturnit (Kronosi) dhe i Reas, zoti i natyres dhe i gjithësisë. Ai ishte sunduesi i tokës dhe i qiellit, banesa e tij ka qene në maja të larta malesh ku vetetima dhe gjemimi rrahin gjithnjë. Në librin me titull "E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët", Pashko Vasa thotë se -bashkimi i Geas dhe Uranit që do të thotë Tokës dhe Qiellit, ka dhënë Rean dhe Chronos (Kohe). Rea në gjuhën shqipe do të thotë "re-grumbuj resh", ndërsa Chronos rrjedh nga fjala kohe.

**Fjalë kyçe:** shqiptaria, albanianizmi, institucioni i familjes, haplotipet, kultura shqiptare, veshja, antropologjia.

## HYRJE

Nga të gjitha mendimet e dhëna apo idetë u vu re se u anashkaluan disa prova dhe fakte të cilat mitin e simbolit tonë kombëtar e lidhin me Dodonën Pellazgjike në malin e Tomorrit, në Shqipëri. Në këtë shkrim nuk do ti hyjmë arsytimit nëse Orakulli i shenjtë i Dodonës Pellazgjike ka qënë në malin e Tomorrit. Kjo është e qartë mjafton të lexohen shkrimet e lashta me kujdes si dhe të analizohen ato me një mendje krejt të kthjellët. Mjafton të studiohen librat dhe punimet të cilat kanë lënë autorë të lashtësisë si Herodoti, Plinius, Strabon, Hesiodi, Plutarku dhe të tjerë. Mjafton të studiohen veprat e rilindasve tanë si Kristoforidhi, Jani Vreto, Sami dhe Naim Frashëri, Çajupi, Ismail Qemali, Eqerem Vlora, Perikli Ikonimi, Ali Asllani, Hil Mosi.

## 1.HISTORIA E SIMBOLIT TONË KOMBËTAR DHE DODONA PELLAZGJIKE

### 1.1 MITI I ZEUSIT PELLAZGJIK LINDI NË TOMORR?

<sup>1</sup>

Nga të gjitha mendimet e dhëna apo idetë u vu re se u anashkaluan disa prova dhe fakte të cilat mitin e simbolit tonë kombëtar e lidhin me Dodonën Pellazgjike në malin e Tomorrit, në Shqipëri. Në këtë shkrim nuk do t'i hyjmë arsytimit, nëse Orakulli i shenjtë i Dodonës Pellazgjike ka qenë në malin e Tomorrit. Kjo është e qartë. Mjafton të lexohen shkrimet e lashta me kujdes, si dhe të analizohen ato me një mendje krejt të kthjellët. Mjafton të studiohen librat dhe punimet, të cilat kanë lënë autorë të lashtësisë, si Herodoti, Plinius, Strabon, Hesiodi, Plutarku dhe të tjerë. Mjafton të studiohen veprat e rilindasve tanë si Kristoforidhi, Jani Vreto, Sami dhe Naim Frashëri, Çajupi, Ismail Qemali, Eqerem Vlora, Perikli Ikonimi, Ali Asllani, Hil Mosi. Shumë autorë dhe midis tyre dhe P. Ikonimi në librin e tij me titull "Historia e Tomorrit" thotë se Zeusi sipas mitologjisë ishte zot i Iliro-Pellazgëve, ai ishte i biri i Saturnit (Kronosi) dhe i Reas, zoti i natyrës dhe i gjithësisë. Ai ishte sunduesi i tokës dhe i qiellit, banesa e tij ka qenë në maja të larta malesh ku vetëtimat dhe gjësimi rrahin gjithnjë<sup>2</sup>. Në librin me titull "E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët", Pashko Vasa thotë se bashkimi i Geas dhe Uranit që do të thotë Tokës dhe Qiellit, ka dhënë Rean dhe Chronos (Kohe). Rea në gjuhën shqipe do të thotë "re-grumbuj resh", ndërsa Chronos rrjedh nga fjala kohe. Nga Reha lindi Zeusi; Zâ; Zë, në gjuhën shqipe do të thotë zëri.

Reha nuk mundet të lindë, veçse me anë të shkrepëtimit, shpërthimit, shpërthimi i cili dha një ton. Kjo është bubullima dhe vetëtimat, pikerisht Zaa- ni, Zee- ri i pellazgëve. Ne e dimë që Zeusi, Orakulli i tij Dodonian, shfaqte zhurmë, me anë të një zëri dhe prandaj Zeeri, Zee, ishte zoti i pellazgëve. Kjo fjalë Zaa, Zee u shndërrua më vonë në Zaan, Zoon, Zoot, dhe sot Zoti, që do të thotë perëndi dhe njerëzit betohen për Zoon, Zoot, Zotin<sup>3</sup>. Në një punim të vitit 1892, për Studime Orientale nga Universiteti i Londrës me titull "Pellazgët dhe Pasardhësit e tyre Modern", botuar nga euriditi Sir Patrick Colquhoun duke mbështetur mendimet e Pashko Vasës midis të tjerave ai thotë se: "...Vendi që përshkruhet si vendi i Zeusit është mali i Tomorrit. Ky mal ekziston në Molopide dhe Thesprotia afër qytetit të Beratit. Është absurde ta kërkojmë këtë mal në Arte. Disa orë larg Beratit është një mal që nga vendasit quhet Tomorr. Në Malin e Tomorrit ka disa fuqi misterioze, ndaj për këto njerëzit e quajnë me fjalët "I Miri i Tomorit". Tinguj ose zhurma tëçuditshme që ka shumë të ngjarë të shkaktohen nga efektet e influencës atmosferike (shkreptima, bubullima, erërat e forta), dëgjohen kohë pas kohe në majen e tij. Këta tinguj në kohë shumë të lashta janë pandehur si Zëri i Zotit. Sipas intesitetit të zhurmave janë bërëparashikimet (ndoshta nga priftërinjtë e Orakullit të Dodonës) nëse do të ketë korrije të mbara apo jo, nëse do të ketë ose jo sëmundje apo luftëra. Këto konfirmoheshin nga "i Miri i Tomorit", Zee i Tomorrit - Zeusi.

Pavarësisht ndërrimit të fesë kjo është ruajtur midis njerëzve. Për këto arsye ka supozime të forta, se mali i Tomorrit ishte vendqëndrimi i Zeusit Pellazgjik, para se ai të largohej në vende të largëta<sup>4</sup>. Studiuesi Britanik Arthur Cook në librin e tij me titull Zeus, Volumi III, Pjesa e Dytë, botuar në Londer në vitin 1940 midis të tjerave thotë se; Janë një grup malesh me emrin Tmor, Tomor apo Tomarus. Mali Tmor në bregdetin e Dalmacisë, në veri-perëndim të Raguzës. Mali Tomor, në Veri të Epirit dhe në Lindje të qytetit të Beratit. Mali Tamaros ose

<sup>2</sup> Perikli Ikonimi, fq. 51

<sup>3</sup> Po aty fq 12

<sup>4</sup> po aty, fq. 211

Tmaros i cili njihet tani me emrin modern Olicka në jugperëndim të Janinës, si dhe mali Tmarion në Arkadia. Në kohët e lashta këto male duhet të kenë qenë habitat natyror të Zeusit. Por nga të gjithë keto male, veteëm në malin Tomor afër Beratit, Zeusi adhurohet sot e kësaj dite. Karakterin e shenjtë të këtij mali e raportojnë me dhjetëra udhëtarë të cilët e kanë vizituar atë (shih në fq.1168). Sipas Sir Colquhoun (i cili siç theksuam më lartë, përkrah idenë e Pashko Vasës), miti i Zeusit ka lindur në Tomorr. Është e vërtetë që në këtë mal dhe sot e kësaj dite kryqëzohen rryma të forta atmosferike të cilat shkaktojnë zhurma tëçuditshme. Shumë e njohur në këtë zonëështë një erë e cila quhet "Stoceni". Ikonomi midis të tjerave për këtë erë thotë: Në Tomorr ekziston një erë e rreptë dhe e fortë si stuhi e cila kujtohet me emrin Stoceni prej popullsisë rreth zonës së Tomorrit. Kjo erë është legjendare për fuqinë që ka në gjithë Tomorrin. Kjo erë e bënë shumë të ftohtë klimën the populli i thotë "Po frynë Tomorja, na preu Tomorja". Fjala Stoceni i erës së Tomorrit, i përngjanë fjalës, Stercenius, që është emër i një perëndie të vjetër, mbrojtës i plehërimit dhe i arave të tokave bujqësore. Këtë perëndi ndoshta e kanë adhuruar Pellazgo - Iliryanët, por dhe Romakët mundet ta kenë lënë këtë emër"<sup>5</sup>. Ndoshta zhurmat dhe tingujt që ka shkaktuar Stoceni, në kohët e lashta janë pandehur si Zëri i Zotit, pra ZEUSIT.

## 1.2 MITI I SHQIPONJËS DYKRENARE

Në librin " The History of Herodotus", botuar nga Profesori i Universitetit të Oksfordit G. Raëlinson, Volume II midis të tjerave thuhet se: "Kjo ishte ajo që kam dëgjuar nga priftërinjtë e Tebes në Dodone, megjithatë gratë që sollën orakullin e shpjeguan kështu këtë histori; Dy pëllumba të zinj erdhën duke fluturuar nga Teba në Egjipt. Ndërsa njëri e vazhdoi fluturimin e tij për në Libi, tjetri erdhi në Dodone. Ai zbriti në një lis dhe filloj të flasë në gjuhën e njerëzve, duke lajmëruar ata se aty duhet të ndërtohej një vend i shenjtë për Zeusin. Njerëzit e Dodonës e kuptuan që ky ishte një mesazh hyjnor dhe aty ndërtuan Orakullin e Dodonës. Pëllumbi që fluturoi në Libi ju tha Libianëve që duhet të ngrihej një tempull, dhe aty u ngrit tempulli Amon.<sup>6</sup>Ekziston një mendim tjetër ndër studiues se, sipas legjendës Zeusi Pellazgjik hodhi jo pëllumba në ajër por dy shqiponja të zeza të cilat pasi i erdhën botës verdallë u bashkuan në Dodonën Pellazgjike në malin e Tomorrit. Këtu lindi dhe miti i shqiponjës me dy koka. E rëndësishme është se në të gjitha imazhet e shfaqura të Zeusit Pellazgjik ai ka përkrahë shqiponjën e cila është simbol i pushtetit dhe i pavdeksisë. P. Ikonomi thotë se: Zeusi në të djathtë mbante rrufenë ose shqipen, ndërsa në të majtë skeptrin (*simbolin mbretëror*).

Të vjetrit pandehnin se Zeusin e mbante mbi krahun e saj shqipja, kur ai donte të zbriste nga qielli mbi Tomorr a gjetkë dhe se kjo e çonte prapë në qiell lartë<sup>7</sup>. Për Ikonomin nuk ka asnjë pikëpyetje që Zeusi kishte shtëpinë në malin e Tomorrit dhe engjëjt mbrojtës të tij ishin shqipet e malit, por këtë mendim ka dhe albanologu gjerman Maximilian Lambertz. Ai në librin e tij me titull, "Die Mithologie der Albaner" Shtutgard 1973, cituar nga shkrimtari beratas Piro Tase në librin e tij me titull "Të Huajt për Shqipërinë dhe Shqiptarët", 2010, në

<sup>5</sup> P. Ikonomin fq.31, 32

<sup>6</sup> shih fq. 83

<sup>7</sup> shih fq. 53

hyrje të librit, thotë se: "Figura legjendare e BABA TOMORRIT në imagjinatën popullore përfytyrohet si një plak i moçëm me mjekër të bardhë dhe të gjatë deri në brez". Mbi të qëndrojnë pezull katër shqiponja femra me sqep të gjatë dhe të fuqishëm dhe që kanë mbështetur kthetrat e tyre mbi supet e rëna dhe të mbuluara me borë. Ai është model i perëndive të lashta ILIRE, pra Lambertz thekson se Baba Tomorrit i qëndrojnë katër shqiponja në krahë, ashtu si Zeusi Pellazgjik.

Po, a është version i Baba Tomorrit (Abaz Aliut) Zeusi i pellazeve? Studiuesi britanik Joseph Sëire në Librin e tij King Zog's Albania, botuar në Londër në vitin 1937, midis të tjerave në faqen 250 përshkruan vjetërsinë e malit të Tomorrit, ndërsa në faqen 253 ai paraqet dy legjenda lokale, njëra prej të cilave midis të tjera flet se: "Më 25 Gusht vite të shkuara, Abaz Aliu profeti i bektashinjve, erdhi nga Arabia në Berat". Ai kaptoj malet me një kalë të bardhë, i cili ka lënë gjurmën e tij të stampuar në malin e Tomorrit. Ai luftoi me armiqtë e Shqipërisë, barbarët, që ishin rreth e qark vendit. Kur ai kishte fituar luftën me barbarët, ai qëndroi për pesë ditë në Malin e Tomorrit. Pastaj ai shkoi në malin Olympus, por çdo vit ai kthehet në 25 Gusht në malin e Tomorrit, duke qëndruar aty pesë ditë. Pra është e qartë se në këtë legjendë J. Sëire e konsideron Baba Tomorrit apo Abaz Aliun, Zeusin Pellazgjik i cili rri në Malin Olympus. Më poshtë Sëire e lidh dhe me homazhet që popullsia e kësaj zone ja kushton Baba Tomorrit për çdo vit në muajin Gusht. Mendimet e Sëire janë në sinkron të plotë me idenë e hedhur nga rilindasi ynë i madh Jani Vreto, i cili në librin e tij "Apologjia", viti 1887 ribotuar në vitet 1980, Vepra të Zgjedhura, thotë se: Gojëdhënat për Tomorrit, dëshmojnë për një ndryshim shumë të vogël, brenda një kohe aq të gjatë dhe kalimin nga politeizmi tek krishtërimi dhe nga krishtërimi në muhamedanizëm<sup>8</sup>. Në librin e tij me titull; Gjahu i Malësorëve (Hieja e Tomorrit) të rilindasit tonë të madh Konstandin Kristoforidhi botuar në Laipcing në 1948 nga albanologu gjerman Maximilian Lambertz dhe ribotuar në Tiranë më 1950 midis të tjerave autori thotë se; Shqiptarët i luteshin Hijes së Tomorrit dhe kishin shqipenë për shenjë të zotit. Këtu Kristoforidhi tregon se shqipja dykrenore është simbol i shqiptarëve. Më poshtë Kristoforidhi paraqet një dialog midis malësorëve të Tomorrit, të cilët kishin dalë për gjueti. Ja si zhvillohet dialogu: "Vështro, o shokë, (i thotë njëri- tjetrit), vështro sesi qënka mbuluar maja e Malit të Tomorrit, me mjegull e me re!" " Shih, shih, si shkrep mali xixa xixa, e nxjerr shkëndia t'arta e t'argjenta!" "Rri Zoti atje, rri i madhi i jetës atje, rri ai që ruan Shqipërinë e s'na le të biemë n'dorë të armiqve." "I qofshim falë atij Zoti. Hija e tij na mbulofte dhe na ruajtë e na sbrarhtë armetë në luftë."

- As më thuaj, kush i shërben Zotit të Tomorrit?

- Shqipet e malit i shërbejnë, ato janë engjëjt e tij, prandaj edhe neve na thonë Shqipëtarë, sepse lusim Zotin e shqipevet edhe jemi të fortë posi ato, edhe shokët e atyre. Tek kanë bërë foletë shqipet nëpër shkëmbinjtë, dhe nëpër shkrepat e maleve atje kemi ngritur shtëpitë edhe neve Malësorët<sup>9</sup>. Ndërkohë edhe etnologu Rrok Zojsi në librin e tij "Folklore" botuar në vitin 1939 duke referuar një legjendë lokale midis të tjerave, thotë se populli i krahinës së Tomorrit beson se në malin e Tomorrit është një "ZOG" (shqiponje) aq i shenjtë, sa s'kapet me dorë. Por legjendat duhen mbështetur dhe me prova të gjalla.

<sup>8</sup> shih fq. 84

<sup>9</sup> shih fq. 18



Nga studiuesi Perikli Ikonimi, por dhe studiues të tjerë si Dionisi Piron në librin, "Aleksandri i Maqedonisë", botuar në Athinë në vitin 1846, si dhe në një liber botuar nga Univesiteti i Kretës në vitin 1910 me titull "Historia e Beratit", citohen shkrimtar të lashtësisë, si Hesiodin dhe Strabonin të cilët midis të tjerave theksojnë se: "Në kohë mjaft të lashta në rrethinat e Beratit dhe Tomorrit, banonin Orestët, dhe se zona e Tomorrit dhe Beratit është quajtur me emrin Orestiadha. Këtë emër kjo zonë e mori sepse Oresti, djali i Agamenonit (njëri nga prijësat e luftës së Trojës), për shkak të vrasjes së të ëmës së tij të cilën e bëri vetë, erdhi dhe u fsheh në këtë zonë. Oresti ngriti afër malit të Tomorrit dhe qytetin e lashtë Argos Orestikon <sup>10</sup>. Ikonimi tregon se Aqilehti i biri i Pileut dhe i Perëndeshës së Detit, kryetari i Lapatheve (Lapathet stërgjyshërit e Lapeve të sotëm) në Luftën e Trojës, i dërgoi në atë kohë një përshëndetje Zeusit të Dodonës Pellazgjike dhe i thotë në formë lutje "O zot, o Dodonës Pellazgjike që banon në ato vende të largëta dhe sundon mbi Dodonën dimërkeqe, përreth teje banojnë Selijtë, Dragomanët (fate-dhënës) këmbëzbathur dhe gjumëpërdheas <sup>11</sup>. Plutarku thotë se fiset që banonin rreth Dodonës ishin Selijtë, Enianët, Perrevejtë, Athamanet, por Perrevejtë dhe Athamanet u dëbuan prej këtu, prej Lapatheve stërgjyshërve të Lapeve të sotëm. Selijtë duke u mbështetur dhe në mendimet e Ikonimit<sup>12</sup> por dhe në librin Historia e Beratit botuar nga Universiteti i Kretës me 1910 ishin banorë të cilët shtriheshin në Sulovën e sotme (Sulovaret). Kurse Lapathet para se të zhvendoseshin në Labëri mendohet të jenë shtrirë në zonën pranë malit të Tomorrit Belesove - Lumas ku aktualisht rrjedh një lum i cili quhet "Laparthic" dhe përgjatë tij shtrihet fshati Lapardha i Beratit (Lapardheasit) i cili ka marrë emrin nga ky lum, por toponimet flasin vetë. Në zonën e Vlorës apo Labërisë ekziston një fshat me emrin Lapardha e Vlorës (Lapardheasit), i cili siç thamë gjendet në zonën e Beratit, ku ka qenë shtrirë fisi legjendar i Lapatheve. Pranë Tomorrit gjenden dhe toponime fshatrash me emrat Narte e Sulovës dhe Kuç i Skraparit, që siç dihet ekzistojnë në Vlorë dhe meritojnë studim. Pas largimit nga krahina e Tomorrit, fisi i Lapatheve ngriti qytetin Iliro Epirot të Orikut (Orikumin e sotëm).

Në librin e Eqerem Bej Vlorës, Kujtime ( 1885- 1925), përkthyer nga gjermanishtja nga Afrim Koçi, botuar në 1972 në Mynih, dhe ribotuar në Tiranë nga shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, në faqen 313 midis të tjerave autori tregon se, në librin e tij "Jetë Paralele" Plutarku, thotë se Piroja mbreti i Epirit pas betejave të Heraldese (280 B.C) kur dëgjoi luftëtarët e tij që po këndonin një këngë dhe e quanin shqiponjë, ai ju tha atyre, n.q.s. unë jam shqiponjë, ju jeni krahët që më sollët fitimtar deri këtu...

NË MONEDHAT TË QYTETIT ILIRO-EPIRIOT TË ORIKUMIT DUKET NJË SHQIPONJË QË MBAN NË KTHETRA RRUFETË E ZEUSIT....(shih fq. 313). Është e qartë se Lapathet e lashtë e ruajtën mitin e shqiponjës dykrenore edhe atje ku shkuan pra në Labërinë e sotme ku bën pjesë dhe qyteti i lashtë i Orikut. Nuk është rastësi udhëtimi i Eqerem bej Vlorës në malin e Tomorrit në Shtator të vitit 1906. Po kështu nuk është rastësi interesimi i Ismail Qemalit për Dodonën e Tomorrit, flitet se Ismail Qemali ka bërë një broshurë për Dodonën, por fatkeqsisht ajo nuk është gjetur deri më sot. Ky simbol pellazgjik u mbajt dhe nga prijësi

<sup>10</sup> shih P. Ikonimin fq.11, si dhe librin Historia e Beratit fq.5 dhe 6

<sup>11</sup> shih Ikonimin fq. 5 cituar Iliadën e Homerit XVI, 234

<sup>12</sup> fq. 9

ynë Skënderbeu i cili e ngriti atë me 28 Nëntor 1943 në kalanë e Krujës. Por historia jonë nuk përmend edhe një fakt. Ishte Skënderbeu që e riktheu shqiponjën e Zeusit përsëri në malin e Tomorrit, në shtëpinë e saj. Në librin e autorit Kenneth Meyer Setton, "The Papacy and the Levant, 1204-1571: The fifteenth century", Volum II, viti i botimit 1978, Filadelfia, SHBA, në faqen 194 thuhet se: "Në Shtator të vitit 1457, Skënderbeu u ngjiti në Majën e malit të Tomorrit, 11 milje në Lindje të Beratit, duke sulmuar ushtrinë turke në mënyrë të befasishme dhe duke korrur një fitore të shkëlqyer mbi ta." Për fat të keq askund nuk është shkruar për këtë betejë e cila paraqitet në këtë libër duke cituar një letërshtëmbim të një prifti me eprorin e tij, kjo letër mban datën 10 Shtator 1457<sup>13</sup>. Në fund të kësaj artikulli dua ta mbyll me një pjesë të vjershës së Perikli Ikonomit kushtuar Dodonës së Tomorrit, ku ai midis të tjerave thotë se:

"Je Tomori Plak, i Zotit të Pelazgëve  
e thonë historianët e përmend Omiri  
tu falë Aqilehti, prijësi i LAPATHEVE  
burri luftës së Trojës, trimi më i miri...  
... Rrëfen bijët e shqipes emrin Shqipëri  
të asaj shpese të shenjtë që rrinë mbi ty  
që mban mbi krah Zeusin Dodonea  
që ndoshta për të gjithë të mbulon ty REA  
Këtë shpese të shenjtë, stërgjyshi shqipëtare  
e pati për shenje të kombësisë së tij  
që në kohë të lashtë, këtë simbol kombëtar  
edhe sot stërnipi e mban në flamur të tij..."

## 2. PËRFUNDIME

- Ishte Skënderbeu që e riktheu shqiponjën e Zeusit përsëri në malin e Tomorrit, në shtëpinë e saj.
- Gojëdhënat për Tomorrin, dëshmojnë për një ndryshim shumë të vogël, brenda një kohe aq të gjatë dhe kalimin nga politeizmi tek krishtërimi dhe nga krishtërimi në muhamedanizëm.

## 3. STUDIME MBËSHTETËSE

1. Eqerem Vlora, Kujtime (1885- 1925) përkthyer nga Afrim Koci, botuar në 1972 në Mynih.
2. Kenneth Meyer Setton, "The Papacy and the Levant, 1204-1571: The fifteenth century", Volum II, viti i botimit 1978, Filadelfia, SHBA.
3. G. Raëlinson, The History of Herodotus, Universitetit të Oksfordit, Volume II,
4. Maximilian Lambert, Die Mithologie der Albaner" Shtutgard 1973.

---

<sup>13</sup> shih fq.194

5. Joseph Sëire, King Zog's Albania, Londer, 1937.
6. Peter (Piro) Tase, Të Huajt për Shqipërinë dhe Shqipëtarët, 2010, SHBA,
7. Cook, Zeus, Cambridge, Londër, 1940.
8. Konstandin Kristoforidhi, Gjahu i Malësoreve(Hieja e Tomorrit), Leipcing 1948, Tirane 1950.
9. Historia e Beratit, Universiteti i Kretes, 1910.
10. Sir P. Colquhoun, "Pellazgët dhe Pasardhësit e tyre Modern", botuar Universiteti i Londrës, 1892.
11. Perikli Ikonomi, Historia e Tomorrit, 1936, Vlore.
12. Jani Vreto, Apologjia, 1878, Ribotuar ne Tirane 1980.
13. Pashko Vasa, E Vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqipëtarët, Paris, 1879, përkthyer nga Skënder Maci.

